

Kuvendi i Organizatës Jofitimprurëse “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare” me seli në Tiranë, në mbledhjen e tij të mbajtur më dt 19/11/2005, konform dispozitave ligjore aprovoi Statutin e “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare” me seli në Tiranë.

## S T A T U T I

- *Kapitulli i parë*

### I. DISPOZITAT THEMELORE

Ky statut do të qeveris shoqatën “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare” me seli në Tiranë, të themeluar në pajtim me rregulloren ndërkontaktore mbi këtë veprimtarit.

- *Kapitulli i dytë*

#### **Neni l. Emri, forma dhe adresa.**

1. Organizata do të quhet Organizata Jofitimprurëse “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare”.
2. Organizata është shoqatë jofitimprurëse sipas definimit të dhënë në rregulloret ndërkontaktore.
3. Organizata nuk do të bëj shpërndarjen e çfarëdo fitimi neto ose të përfitimit si të tillë për asnjë individ. Pasuria, të ardhurat dhe përfitimi i organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar benificione të veçanta individuale qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë për asnjërin nga themeluesit, apo donatorët të OJF-së. Megjithatë pagesa e kompenzimit të arsyeshem për stafin profesional mund të bëhet për punën që ata e kryejnë për këtë organizatë.
4. Ndonjë transakcion në mes të anëtarëve të Bordit Drejtues apo nënpunësit dhe organizatës duhet të mbyllët në vlera reale të tregut ose në kushte që janë më të favorshme për organizatën.
5. Forma e punës së organizatës duhet të bazohet në parimin e mospërfshirjes në vendimarrje politike, altruiizmin (interesi i përgjithshëm shoqëror, pa ndonjë interes parcial), transparencën dhe ligjshmërinë.
6. Organizata “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare” do ta ketë selinë në Tiranë.

## • *Kapitulli i tretë*

### *Neni 2.*

Themeluesit e OFJ-së “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare” me seli në Tiranë, janë:

1..... 2..... 3.....

Përfaqësuesi i autorizuar i OFJ-së “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare” me seli në Tiranë, është Kryetari i Organizatës .....

Përfaqësuesi i autorizuar emërohet nga Bordi Drejtues dhe duhet të përfaqësoj organizatën në të gjithë hapësirën ku ajo shtrin aktivitetin e saj (në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni) dhe të pranoj të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës.

Ai duhet të jetë përgjegjës për informimin e autoriteteve relevante të administratës për çfarëdo ndryshimi në organizatë.

## • *Kapitulli i katërt*

### **Neni 3. Objektivat/Qëllimet**

1. Ngritura e nivelit profesional të punonjësve të shëndetit mendor.
2. Përparimi i psikiatrisë shqiptare konform arritjeve bashkëkohorë në këtë lëmi.
3. Krijimi i urave të bashkëpunimit midis profesionistëve që vijnë nga vende të ndryshme, por nga e njëta kulturë, gjuhë dhe traditë.
4. Marrjen e iniciativave që kanë për qëllim ngritjen e nivelit të shërbimeve të shëndetit mendor.
5. Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë mbi problematikën e shëndetit mendor.
6. Bashkëpunimi me OFJ-të simotra në regjion dhe më gjerë.
7. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të pacientëve të kësaj lëmie, konform kartave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pacientëve.

Për të përmbushur qëllimet e saj, organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në aktivitetet e poshtëshënuara:

### **Neni 4. Aktivitetet**

- Organizimi i takimeve, seminareve, konferencave ku do të diskutohet mbi problematikën e shëndetit mendor në hapësirën shqiptare.
- Publikimi i librave, punimeve shkencore, broshurave me karakter profesional apo edukativ.
- Ngritura e grupeve shkencoro-professionale për standartizimin e instrumenteve, nomenklaturës apo të elementëve të tjerë të rëndësishëm në lëminë e psikiatrisë.

- **Kapitulli i pestë**

### **Pjesa e parë: Rregullat e Përgjithshme.**

#### **Neni 5. Anëtarësimi**

Anëtarësimi në organizatë është i hapur për profesionistët e shëndetit mendor pa dallim racor, gjinor, etnik, orientimi seksual, religjioni, moshe ose aftësie fizike.

Bordi Drejtues vendos për kriteret e anëtarësimit dhe kuotën e anëtarësimit nga anëtarët e organizatës.

#### **Pjesa e dytë: Pranimi i anëtarëve të rinj.**

#### **Neni 6.**

Anëtarësimi i anëtarëve të rinj në organizatë bëhet përmes kërkesës me shkrim të tij dhe aplikacionit që i adresohet sekretarit të Organizatës.

Kërkesa dhe aplikacioni për pranimin e anëtarit të ri do të diskutohet nga Bordi Drejtues i cili vendos për pranimin e kandidatit, bazuar në kriteret e fiksuar të antarësimit.

Vendimin e përkohshëm për pranimin e anëtarit të rregullt e merr Bordi Drejtues, kurse vendimi bëhet definitiv kur për të vendos Kuvendi.

Propozimi për pranimin dhe përjashtimin e anëtarëve duhet të përfshihet në axhendën e mbledhjes të Bordit Drejtues. Në rastin kur këto çështje nuk janë përfshirë dhe diskutuar Bordi Drejtues nuk mund të marrë vendim për këto.

#### **Pjesa e tretë: Përfundimi i anëtarësisë.**

#### **Neni 7.**

Anëtarësimi në organizatë ndërprenhet në bazë të kërkesës me shkrim që i paraqitet Bordit Drejtues.

#### **Neni 8.**

Anëtarësimi në organizatë ndërprenhet sipas procedurës të përcaktuar. Në këtë rast duhet të ekzistoj prova e formës së shkruar .

## **Neni 9.**

Anëtari i organizatës do të përjashtohet me vendimin e Kuvendit në raste si:

1. Nuk i respekton kushtet e statutit,
2. Nuk i merr parasysh vendimet e Kuvendit dhe Bordit Drejtues,
3. Seriozisht dëmton reputacionin e organizatës.
4. Nuk merr pjesë në punën e dy mbledhjeve të një pas njëshme të Kuvendit, pa ndonjë arsyé valide, nëse i është bërë ftesa në mënyrë të rregullt.

Vendimi për këtë merret me shumicën e anëtarëve që janë prezent.

Vendimi do të merret edhe nëse anëtari që do të largohet nuk është i pranishëm, pasi të sigurohemi se ai/ajo është ftuar dhe nuk është paraqitur pa ndonjë arsyé valide.

### **• *Kapitulli i gjashtë***

## **Neni 10. Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve**

Anëtarët e Kuvendit kanë këto të drejta:

1. Të marrin pjesë në të gjitha format e aktiviteteve.
2. Të propozojnë dhe zgjedhin anëtarët e Bordit Drejtues dhe të Këshillit Mbikqyrës.
3. Të informohen rregullisht për të gjitha aktivitetet e organizatës.
4. Të jenë rregullisht të informuar për ngjarjet dhe aktivitetet e Bordit Drejtues.
5. Të njihen me reportin finansiar të shoqatës.
6. Të propozojnë ndryshime në statut, i cili bëhet së paku nga 1/3 e anëtarëve të Kuvendit.
7. Të japid propozime për “Anëtar Nderi” të LPSH, i cili bëhet me së paku 15 nënshkrime të anëtarëve të LPSH.

## **Neni 11.**

Anëtarët e organizatës marrin përsipër që:

1. Të punojnë sëbashku për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të Statutit dhe të Bordit Drejtues.
2. Të respektojnë statutin dhe rregullat e brendëshme për zgjedhje dhe punë të anëtarëve të organizatës të aprovar nga Bordi Drejtues.
3. Të paguaj kuotizacionin e anëtarësisë me rregull.

- *Kapitulli i shtatë*

## **Neni 12. Organet dhe Qeverisja**

Organet e OFJ-së “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare” me seli në Tiranë, janë:

1. **Kuvendi i Organizatës**
2. **Bordi Drejtues**
3. **Kryetari i organizatës**
4. **Këshilli mbikqyrës.**

## **Neni 13.**

Kuvendi i anëtarëve është organi me i lartë qeverisës i organizatës. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve të organizatës.

## **KUVENDI I OFJ-së “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare” me seli në Tiranë.**

## **Neni 14.**

Kuvendi i OFJ-së “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare” me seli në Tiranë, ka këto autorizime dhe kompetenca:

1. Aprovon statutin, ndryshimet dhe plotësimet e tij.
2. Aprovon programin e punës dhe raportin financiar.
3. Zgjedhë dhe emëron anëtarët e Bordit Drejtues, të Këshillit Mbikqyrës dhe Sekretarin e Organizatës.
4. Vendos mbi çështjet tjera në pajtim me këtë statut, programin e punës dhe rregulloren mbi punën e Kuvendit.
5. Aprovon kandidaturën për “Anëtar Nderi” të LPSH që ka marrë miratimin e BD të LPSH

## **Neni 15.**

Kuvendi i Organizatës mban takimet sipas nevojës, e më së paku njëherë në 3 vjet.

Kuvendin e thérret Kryetari i Organizatës, i cili emëron edhe kryesinë e punës.

Kryetari i Organizatës është i obliguar të thërras Kuvendin nëse këtë e kërkon Bordi Drejtues apo 1/3 e anëtarëve të Kuvendit, në afat prej 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Kuorumi ekziston nëse në Kuvend janë prezent mbi 50% të anëtarëve.

Çdo anëtar i Kuvendit ka një votë.

Vendimet e Kuvendit janë të plotëfuqishme nëse për ato votojnë mbi 50% të anëtarëve të pranishëm dhe janë të obliguara për të gjithë anëtarët.

Vendmbajtja e Kuvendit bëhet sipas rotacionit të përcaktuar paraprakisht.

## **BORDI DREJTUES I OFJ-së “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare”**

### **Neni 16.**

Bordi Drejtues numëron 11 anëtarë (pesë përfaqësues nga Shqipëria, pesë nga Kosova dhe një nga Maqedonia).

Bordi Drejtues përbëhet nga anëtarët e organizatës.

Nga Maqedonia do të përgjidhet edhe një anëtar i dytë në BD i cili do të ndihmojë në punën e tij anëtarin e parë dhe do ta zëvendësojë atë sa herë që nuk e ka të mundur pjesëmarrjen në mbledhjet e BD.

### **Neni 17.**

Bordi Drejtues i OFJ-së “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare” me seli në Tiranë, ka këto autorizime dhe kompetenca:

1. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe dy Nënkyetarët e OFJ-së.
2. Zgjedh Sekretarin dhe ia propozon Kuvendit për miratim. Detyrat dhe përgjegjësite e sekretarit percaktohen me rregulloren e punës të nxjerrë nga BD.
3. Zgjedh dhe shkarkon punëtorët tjerë me autorizime apo përgjegjësi të veçanta.
4. Aprovon aktet e përgjithshme të OFJ-së, përveç statutit të cilin e aprovon Kuvendi.
5. Aprovon llogaritë periodike dhe vjetore.
6. Aprovon aktin e përgjithshëm mbi formën e vulës dhe shenjën mbrojtëse për identifikim vizual.
7. Aprovon rregulloren mbi punën e vet.
8. Përcakton kriteret për anëtarësim në organizatë
9. Kryen edhe punë të tjera në përputhshmëri me programin e punës dhe vendimet e Kuvendit.
10. Përcakton kriteret për statusin “Anëtar Nderi” i LPSH dhe e aprovon kandidaturën me 3/5 e votave.
11. Përcakton kriteret për statusin i “Ftuar Nderi” i LPSH në aktivitetet që organizon dhe e miraton kandidaturën me shumicë të thjeshtë të votave.

### **Neni 18.**

Punën e Bordit Drejtues e udhëheq Kryetari e në mungesë të tij Nënkyetari.

Kryetari zgjedhet me mandat trevjeçar dhe mund të rizgjedhet përsëri.

Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues është tri vite, me të drejtë rizgjedhje.

### **Neni 19.**

Bordi Drejtues mban mbledhjet e veta së paku dy herë në vit.

Mbledhjet i thërrret Kryetari i OJF-së, por mund të thirren edhe me iniciativen e 1/3 të anëtarëve të Bordit Drejtues ose në bazë të kërkesës së stafit profesional të organizatës.

Bordi Drejtues mund ti mbaj takimet në përbërje të zgjeruar ku përveç anëtarëve të bordit marrin pjesë edhe anëtarët e komisioneve përkatëse profesionale, varësisht prej çështjeve që shqyrtohen.

Anëtarët e Bordit Drejtues ftohen së paku 2 javë para mbajtjes së mbledhjes, çdo anëtar thirret me shkrim, me rend dite të përcaktuar për mbledhje.

Mosardhja e rregullt në mbledhje e anëtarit të Bordit, së paku tre takime të njëpasnjëshme pa arsyje, ka si pasojë zëvendësimin e tij, përkatësisht zgjedhjen e anëtarit të ri.

## **KRYETARI I OJF-së** “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare” me seli në Tiranë.

### ***Neni 20.***

Mandati i Kryetarit, Nënkyetarëve, Sekretarit dhe i punëtorëve me autorizim apo përgjegjësi të veçanta zgjatë tri vite.

Pas skadimit të mandatit, të njëjtit mund të zgjedhen sërisht edhe për një mandat tjeter. Kryetari dhe Nënkyetari zgjidhen nga Bordi Drejtues, por ata mund të jenë edhe anëtarë exoficio të tij.

Kryetari i OJF-së, ka këto autorizime:

1. Përfaqëson OJF-në para personave të tretë dhe është përgjegjës për punën e ligjëshme të OJF-së dhe i përgjigjet Bordit Drejtues.
2. I propozon Bordit Drejtues plan-programin e punës dhe kujdeset për zbatimin e ligjit me përpikëri.
3. Zbaton vendimet e Kuvendit dhe Bordit Drejtues.
4. Bën zgjedhjen dhe emërimin e kandidatëve në punë, në kohë të pacaktuar dhe të caktuar.
5. Propozon sistematizimin e vendeve të punës të OJF-së, në rast se do të jetë e nevojshme.
6. Vendos mbi të drejtat e të punësuarëve pranë OJF-së dhe lidhë marrëdhënie po me të njëjtit.
7. Parashtron raportin financiar pranë Bordit Drejtues.
8. Kryen punë tjera në pajtim me Statutin, programin e punës dhe me vendimet e Kuvendit dhe Bordit Drejtues të OJF-së.

## *Neni 21.*

Kryetari i OFJ-së ose/edhe Nënkyetarët shkarkohen nga detyra prej Bordit Drejtues:

1. Nëse nuk përbushin detyrimet të cilat i përcakton statuti
2. Nëse dëmtojnë reputacionin e Organizatës
3. Nëse ka parregullsi financiare të pajustifikueshme në Organizatë
4. Ky vendim merret nga 2/3 e anëtarëve të Bordit Drejtues

## **KËSHILLI MBIKËQYRËS.**

## *Neni 22.*

Këshilli mbikëqyres ka tre anëtarë, të cilët zgjedhen nga Kuvendi.

Anëtarë të këshillit mbikëqyres zgjedhen në afat prej tri vitesh me të drejtë rizgjedhje.

Këshilli mbikëqyres ka këto autorizime dhe kompetenca:

1. Të kontrolloj aktivitetet financiare dhe shpenzimet e organizatës në përputhje me ligjin dhe statutin.
2. Të kontrolloj implementimin e vendimeve të Kuvendit dhe të Bordit Drejtues.
3. Të raportojë për aktivitetin e tij para Kuvendit.

### • **Kapitulli i tetë**

## *Neni 23.*

### **Financimi dhe Prona**

Prona e organizatës përbëhet nga e drejta në pronësi, pronësia intelektuale dhe e drejta e ndasimit në organizatë.

Burimet financiare për aktivitetin e organizatës janë:

1. Të hyrat nga shërbimet e kryera.
2. Donacionet, subvencionet, ndihmat financiare, projektet e finançuara në kuadër të programeve regionale ose ndërkombëtare.
3. Të hyrat vjetore nga anëtarësimi.

Organi kompetent i cili mund ti pranoj donacionet dhe dhuratat në emër të OJF-së është Bordi Drejtues dhe Kryetari.

Prona e OJF-së shfrytëzohet ekskluzivisht për realizimin e qëllimeve të saj dhe nuk mund të shfrytëzohet për asnjë qëllim tjeter në kundërshtim me këtë statut dhe ligjet në fuqi.

### • **Kapitulli i nëntë**

#### *Neni 24.*

#### **Arkiva**

OJF-ja posedon arkivën e vet.

Është obligative që në arkivë të vendoset kopja e statutit, kopja e aplikacionit dhe vendimi për regjistrim, adresari i anëtarëve, planet vjetore dhe raportet për aktivitetet e OJF-së si dhe proçesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit dhe të Bordit Drejtues.

### • **Kapitulli dhjetë**

#### *Neni 25.*

#### **Shpërndarja e OJF-së**

OJF-ja mund të shpërndahet me vendimin e Kuvendit.

OJF-ja mund të shuhet me vendimin e 2/3 të anëtarëve prezent.

OJF-ja mund të shuhet me vendimin e Gjykatës kompetente në këto raste:

1. Nëse në periudhën 3 mujore OJF-ja ka më pak anëtar se që duhet sipas këtij statuti, për formimin e Bordit Drejtues.
2. Nëse aktivitet e OJF-së janë në kundërshtim me ligjet dhe me këtë statut.
3. Nëse OJF-ja falimenton.

Për kushtet në 1 dhe 2, Bordi Drejtues është i obliguar që të njoftoj organet kompetente që të bëjnë çrrregjistrimin.

*Neni 26.*

## **Rregullat Speciale**

Tridhjetë ditë pas aprovimit të tekstit të ri të statutit me plotësimet dhe ndryshimet e bëra, Bordi Drejtues është i obliguar të njoftojë strukturat legjislativë në vendin ku regjistrohet organizata.

## **Dispozitat Përfundimtare**

Ky statut me plotësimet dhe ndryshimet e bëra hynë në fuqi pasi që aprovohet nga Kuvendi themelues i anëtarëve të OJF-së “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare” me seli në Tiranë.

*Neni 27.*

Për çështjet që nuk janë të rregulluara për këtë statut aplikohen ligjet në fuqi.

Nënshkruar nga:

( anëtarët e Bordit Drejtues)

---

---

---